REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.17, datë 31.03.2026, me titull "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shkurt 2026".

Analiza ligjore:

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet 9 dhe 24; Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike"; Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 3 datë 29.01.2026 "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026"; dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë nr. 153 datë 23.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Projektvendimi synon shpërndarjen e ndihmës ekonomike për muajin shkurt 2026, nga të ardhurat e bashkisë, për 57 familje në total, me një fond prej 228,312 lekë. Shpërndarja bëhet si më poshtë:

· Për Qendrën e Bashkisë Sarandë: 45 familje me 161,982 lekë.
· Për Njësinë Administrative Ksamil: 12 familje me 66,330 lekë.

Projekti përcakton edhe përjashtimin e disa familjeve nga skema, pasi ato tashmë përfitojnë nga skema 6% e bllok-ndihmës ekonomike .

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Shuma totale prej 258,834 lekë parashikohet të shpenzohet nga të ardhurat e bashkisë, në përputhje me buxhetin e miratuar për vitin 2026 dhe kriteret për ndihmën ekonomike.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social do të monitorojë shpërndarjen e subvencionimeve dhe do të raportojë.

Impakti social / grupet që preken:

57 familje në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale në Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil, duke përfshirë:

· Familje rome me fëmijë të mitur.
· Familje me probleme të rënda shëndetësore dhe pa të ardhura.
· Gra kryefamiljare në prag pensioni ose me të ardhura të pamjaftueshme.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim

Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale i propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit projektvendimit Nr.17, datë 31.03.2026, me titull "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shkurt 2026".

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.16,date 31.0232026, me titull "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin shkurt 2026".

Analiza ligjore:

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet 9 dhe 24; Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 617 datë 22.09.2022; Udhëzimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind"; dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr.3, datë 29.01.2026 "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projektvendimi synon përdorimin e fondeve të kushtëzuara për ndihmë ekonomike mujore deri në 6% të buxhetit vendor, për muajin shkurt 2026. Një total prej 22 familjeve do të përfitojnë një ndihmë totale prej 75,753 lekë, e shpërndarë si më poshtë:

· Për Bashkinë Sarandë: 21 familje me një fond total prej 69,872 lekë (sipas listës nr. 1).
· Për Njësinë Administrative Ksamil: 1 familje me një fond prej 5,881 lekë (sipas listës nr. 2).

Nga lista e familjeve përfituese (Lista nr. 1), vihet re se pjesa dërrmuese e tyre përbëhen nga kryefamiljare gra, pensioniste ose në prag pensioni, të cilat janë skualifikuar për shkak të pikëve të pamjaftueshme në skemën e ndihmës ekonomike, por megjithatë përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6% për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike dhe sociale. Një rast i veçantë në Listën nr. 2 është familja me një fëmijë me probleme të rënda shëndetësore.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Shpenzimet parashikohen në kuadër të fondit të kushtëzuar për ndihmë ekonomike, brenda kufirit të 6% të buxhetit vendor për vitin 2026. Shuma totale prej 75,753 lekë do të shpërndahet në bazë të listave të miratuara.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, do të monitorojë shpërndarjen e fondeve dhe do të raportojë për përdorimin e tyre në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Impakti social / grupet që preken:

22 familje në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale në Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil, me fokus të veçantë te gratë kryefamiljare, pensionistet dhe familjet me fëmijë me probleme të rënda shëndetësore.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim
Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale I propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit Nr.16, datë 31.03.2026, me titull "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin shkurt 2026".

Laureta Ceci _____ **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike _____ **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili _____ **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i ekonomisë dhe financës

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.18, datë 31.03.2026, me titull"Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit Edi Alikaj, Ollga Vogli, Melina Nika, Manushaqe Llodos, të prekur nga përmbytjet gjatë muajit nëntor 2025".

Analiza ligjore:
Duke u mbështetur në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjin nr. 45 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414 datë 02.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"; dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projektvendimi synon dhënien e ndihmës financiare për katër shtetas, banesat e të cilëve u dëmtuan nga përmbytjet e muajit nëntor 2025 në zonën Çukë-Berdeneh të Bashkisë Sarandë.

Në bazë të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 358 datë 25.11.2025, u ngrit grupi i punës për verifikimin dhe vlerësimin e dëmeve. Pas konstatimit të dëmeve ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake, Bashkia Sarandë iu drejtua Këshillit të Qarkut Vlorë për asistencë. Këshilli i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 153/01 prot datë 12.02.2026, vuri në dispozicion procesverbalet e Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve në Fatkeqësitë Natyrore.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Efektet financiari do të përballohen nga fondi i transfertës së kushtëzuar të Emergjencave Civile, i parashikuar në Programin "Emergjenca Civile" në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2026 (miratuar me VKB nr. 153 datë 29.12.2025).

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Financave dhe Sektori i Emergjencave Civile.

Impakti social / grupet që preken:

Katër familje të prekura drejtpërdrejt nga përmbytjet e nëntorit 2025 në zonën Çukë-Berdensh, të cilat kanë pësuar dëme ndërtimore dhe humbje të pajisjeve elektroshtëpiake.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim

Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i ekonomisë dhe financës

I propozon Këshillit Bashkiak: projektvendimit Nr.18, datë 31.03.2026, me titull "Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit E. A,O.V, M. N, M. Ll, të prekur nga përmbytjet gjatë muajit nëntor 2025".

Pranvera Osmani ____ **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Ilir Gërdhuqi _____ **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)